




Pranuar / Dorezuar Pritmjenol/Prodato Received/Delivery	17.12.2021	viti god year	2021
Organ./Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRKMSHCK	6216/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.899/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arditë Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Ilire Mehmeti - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.899/2021 të datës 03.11.2021 të parashtruar nga grup ankuesish të përfaqësuar nga ankuesi -me adresë Rr. "Yllka Domi", Nr.16, Prishtinë, kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 17.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.899/2021 e datës 03.11.2021 e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesi

dhe të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 03.11.2021 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 5252/2021 të regjistruar me numër A.nr.899/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore 08.10.2018 - 07.06.2021, gjatë kohës së ushtrimit të detyrave në Qendrën e Paraburgimit në Hajvali.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.11.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesve nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. Këshilli më datë 10.11.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova:
Ankesën me numër të protokollit 5252/2021 të datës 03.11.2021 të regjistruar me numër A.nr.899/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 27.09.2021 me numër të protokollit 1092; Kërkesën e datës 28.09.2021 me numër të protokollit 1099; Emalin e datës 26.10.2021; Emalin e datës 22.11.2018; Emalin e datës 02.06.2021; Lista e datës 31.12.2019 për stafin e drejtorisë në QP Prishtinë; Listën për hyrje dalje të datës 20.11.2018; kuponët fiskal të datës 10.08.2020, 24.04.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.11.2021 me numër të protokollit 5320/2021; Përgjigja në ankesë të datës 10.11.2021 me numër të protokollit 5376/2021; Emali i datës 26.10.2021; Aktin e Emërimit të datës 05.03.2013 të zyrtarit Aktin e Emërimit të datës 03.09.2012 të zyrtarit Aktin e Emërimit të datës 16.11.2018 të zyrtares Aktin e Emërimit të datës 06.06.2019 të zyrtarit Aktin e Emërimit të datës 16.11.2018 të zyrtares Aktin e Emërimit të datës 05.03.2013 të zyrtares Ndryshimin dhe Plotësimin e aktit të emërimit të datës 05.04.2017; Aktin e Emërimit të datës 20.11.2018 të zyrtarit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa A.nr.899/2021 e datës 03.11.2021 është e pa bazuar, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës rezultojnë se ankuesit janë nëpunës civil të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Të njëjtit me datë 27.09.2021, përmes shkresës me numër protokollit 1092 i janë drejtuar Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, me kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën 08.10.2018 - 07.06.2021 për faktin se të njëjtit pretendojnë se me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, në këtë periudhë kohore kanë qenë të transferuar për ushtrimin e detyrave të punës, nga objekti i ish Rilindjes, në Qendrën e Paraburgimit në Hajvali.

Ankuesit kërkesën e tyre e mbështesin në dispozitat e nenit 5 paragrafi 5 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, si dhe nenin 9 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

I autorizuari i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, përmes emailit zyrtar të datës 26.10.2021 ka refuzuar kërkesën e datës 27.09.2021 të parashtruar nga ankuesit, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, me arsyetimin se të njëjtit vetëm janë caktuar të punojnë në hapësira tjera të punës brenda territorit të Prishtinës, dhe se nuk është gjetur ndonjë vendim mbi transferimin e tyre.

Pas refuzimit të kërkesës nga organi i punësimit, ankuesit me datë 03.11.2021, me bazë të njëjtë juridike kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesve ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka gjetur se Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së me datë 22.09.2018 ka bërë njoftim lidhur me vendosjen e disa njësive në pjesën e rinovuar, në katin e 6 të Ndërtesës së ish Rilindjes, mirëpo në kuadër të shkresave të lëndës nuk ka gjetur ndonjë vendim të organit të punësimit përmes të cilit është bërë transferimi i ankuesve, siç pretendojnë të njëjtit. Andaj, meqenëse nuk është gjetur ndonjë vendim i organit të punësimit, lidhur me



transferimin e ankuesve në pozita tjera të punës, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesve për realizimin e shpenzimeve të udhëtimit duke u thirrur vetëm në emailin e datës 22.09.2018, dhe mbi bazën e dispozitave të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, është i pa bazuar.

Dispozitat e nenit 5 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil i referohen rasteve të transferimit të përkohshëm të nëpunësve civil në vend tjetër të punës, për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme në të njëjtën kategori, gradë dhe hap të pagës, por jo edhe rasteve kur institucioni e ndërron lokacionin e punës si në rastin konkret. Nder tjera, në paragrafin 3 të nenit 5 të kësaj rregullore përcaktohet se: *pas kalimit të periudhës së transferimit nëpunësi civil kthehet në pozitën paraprake*, ndërsa në rastin konkret ankuesit nuk kanë sjellë asnjë provë përmes të cilave dëshmohet se të njëjtat janë transferuar në pozita tjera të punës dhe pastaj me përfundimin e periudhës se transferimit janë kthyer në pozitat e tyre paraprake.

Kolegji, vlerëson se dëshmitë e dorëzuara nga parashtruesit e ankesës nuk e mbështesin pretendimin e tyre lidhur me transferimin e përkohshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil, dispozita këto të aplikueshëm në kohën për të cilën ankuesit pretendojnë se janë transferuar nga organi i punësimit, kështu që pretendimet ankimore të ankuesve janë të pa bazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.899/2021

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Proqesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesve,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK);
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në SHKK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

